

BASHKOJU KONKURSET TË FOTOGRAFIKË

**ASGJË PËR NE, PA NE: OBJEKTIVI
DREJT SË ARDHMES**

YOUTH-AL@OSCE.ORG

APLIKO
DERI NË
01 PRILL

**20
22**

SFONDI

Të rinjtë kanë rol thelbësor për krijimin e shoqërive të sigurta dhe paqësore. OSBE-ja, në përputhje me Kuadrin tonë për Fuqizimin e Përparimit për të Rinjtë dhe Sigurinë, si dhe në përputhje me Rezolutën 2250 të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, kërkon të përkrahë potencialin e të rinjve si shtytës pozitivë të ndërtimit të paqes, sigurisë dhe demokratizimit.

Besimi ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë përbën një aspekt shumë të rëndësishëm të kohezionit shoqëror dhe të paqes. Sidoqoftë, përgjatë Ballkanit Perëndimor, të rinjtë shfaqin nivele relativisht të ulëta të besimit tek qeveritë, vendimmarrësit, kuvendet, gjyqësori, policia dhe media.[1] Konsolidimi i demokracisë ka treguar se ka ndikim pozitiv tek siguria dhe tek kohezioni shoqëror[2], si dhe u ofron qytetarëve mekanizma mundësues për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për të ndikuar tek rezultatet e politikave.

Të rinjtë në Ballkanin Perëndimor duan të përmirësojnë shoqëritë në të cilat jetojnë, por nuk ndjehen gjithmonë të fuqishëm për të ndikuar tek ndryshimi. Edhe pse të rinjtë e rajonit, duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë, tregojnë interes dhe e njohin rolin e tyre për të ndikuar tek proceset politikëbërëse, për të kërkuar llogari nga institucionet publike, për të formësuar normat kulturore dhe praktikat, ndërsa plotësojnë përparimet e qeverisë në kuadër të ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, vetëm 19.5% e tyre marrin pjesë në mënyrë veprorë në veprimtari civile.[3]

[1] PNUD, UNFPA, RYCO (2021). E Ardhmja e Përbashkët: Perceptimet e të Rinjve për Paqen në Ballkanin Perëndimor

[2] Kohezioni shoqëror është aftësia e shoqërisë për të siguruar mirëqenien e anëtarëve të saj, duke minimizuar pabarazitë dhe duke shmangur marginalizimin. <https://www.coe.int/t/dg3/> (Raport i Grupit të Punës të Nivelit të Lartë për Kohezionin Shoqëror në shekullin 21)

[3] PNUD, UNFPA, RYCO (2021). E Ardhmja e Përbashkët: Perceptimet e të Rinjve për Paqen në Ballkanin Perëndimor

Liria e fjalës dhe toleranca përbëjnë të drejta bazë të njeriut dhe parakushte të demokracisë dhe jetesës në paqe, të sigurisë dhe pjesëmarrjes së lirë në jetën politike, civile, dhe kulturore të komunitetit. Studimet dëshmojnë se potenciali i të shprehurit vetjak përbën tregues të fortë të gatishmërisë së shoqërisë për të funksionuar si demokraci e efektshme[4]. Arti dhe kultura janë shprehje që ndërtojnë shoqërinë; me anë të krijimit artistik dhe shprehjes kulturore ne ndërgjegjësojmë shoqërinë rreth shqetësimeve dhe vështirësive me të cilat përballen të rinjtë, duke i ofruar të rinjve hapësirën dhe mënyrën për tu shprehur në forma krijuese. Prandaj, ne e përdorim artin si mjet për të krijuar përvoja të përbashkëta të të rinjve shqiptarë, në mënyrë që këta të fundit të përçojnë mesazhe të rëndësishme dhe të rrisin ndërgjegjësimin rreth çështjeve më të rëndësishme për ta.

[4] <https://www.britishcouncil.org/research-policy-insight/insight-articles/cultural-evolution-democracy>

Nëpërmjet konkursit fotografik 'ASGJË PËR NE, PA NE: OBJEKTIVI DREJT SË ARDHMES' ne synojmë të nxisim të rinjtë në Shqipëri të kapin aspekte të ndryshme dhe praktika aktuale të pjesëmarrjes demokratike dhe qytetarisë veprore që janë premtuese dhe që i motivojnë dhe i frymëzojnë ata/ato të ndikojnë tek rezultatet e politikave dhe të sjellin ndryshim në komunitetet e tyre. Qëllimi është nxitja e rolit dhe përfshirjes së të rinjve për përkrahjen e vlerave demokratike nëpërmjet pikëpamjes artistike.

Duke përkrahur punimet e fotografëve të rinj, fillestarëve, studentëve dhe aktivistëve të interesuar për artet pamore dhe proceset krijuese, misioni ynë është t'u ofrojmë të rinjve shqiptarë një platformë ku të shfaqin punimet e tyre dhe t'u përçojnë të gjithë shoqërisë mesazhet, idetë, mendimet apo shqetësimet në lidhje me pjesëmarrjen demokratike dhe qytetarinë veprore.

Konkursi Fotografik organizohet në kuadër të projektit "Vëmendja tek të Rinjtë II: Përkrahja e Rolit të të Rinjve për Paqen dhe Sigurinë në Shqipëri" – projekt ky i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Ambasada e Greqisë në Shqipëri dhe nga Misioni i Përhershëm i Italisë në OSBE.

Tema

Të Rinjtë dhe Pjesëmarrja Demokratike

Çmimet

Çmimi i Parë – Apple iPhone 13 Pro

Çmimi i Dytë – Aparat: GoPro HERO10

Çmimi i Tretë – Aparat: Fujifilm Instax Mini 11 Instant Camera

Kush mund të marrë pjesë

Konkursi fotografik është i hapur për personat ndërmjet moshës 15 dhe 29 vjeç që jetojnë në Shqipëri. Lejohen punime për profesionistët, fillestaret, studentët e fotografisë, dhe për aktivistët në vend. Konkursi është i hapur për të gjitha llojet e fotografive të shkrepura që nga 1 janari i vitit 2020. Punimet nuk duhet të reklamojnë vepra të dhunshme, forma të abuzimit apo të kremtojnë vuajtjen e poshtërimin. Dorëzimi në kohë i punimeve që përmbushin kushtet e pjesëmarrjes që përshkruhen këtu bën të mundur që punimet të shqyrtohen dhe mundësisht të përzgjidhen.

Kushtet Teknike

Lejohet dorëzimi i punimeve nga data **15 mars në datën 1 prill 2022**.

Pranohen si fotografitë me ngjyra edhe ato bardhë e zi. Pjesëmarrësit mund të dorëzojnë deri në tre fotografi nga të cilat vetëm njëra mund të marrë çmim. Fotografitë që dorëzohen për qëllim të konkursit duhet të jenë me rezolucion të lartë, të përshtatshëm për larje dhe ekspozim.

Fotografitë e konkursit duhet të ruhen në formatin jpg/jpeg, 150-300 dpi dhe cilësi kompresimi 7-12, me brinjë të shkurtër 1920 piksel minimumi dhe brinjë të gjatë 3200 piksel maksimumi, dhe madhësia e materialit nuk duhet të jetë më pak se 2 Mb dhe më shumë se Mb. Fotografitë me celular përjashtohen nga kriteri i madhësisë, por duhet të dorëzohen sipas rezolucionit më të lartë që kanë.

Pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë fotografitë nëpërmjet postës elektronike në adresën: youth-al@osce.org, dhe të përfshijnë informacionet e mëposhtme: emër, mbiemër, numrin e telefonit, datën e lindjes dhe titullin e fotografisë/fotografive në anglisht ose në shqip. Për secilën fotografi të dorëzuar, tregoni titullin përkatës.

Subjekti i emailit duhet të jetë: “ASGJË PËR NE, PA NE”. Punimet që nuk shoqërohen nga informacioni i sipërpërmendur do të gjykohen si të pavlefshme dhe do të përjashtohen nga konkursi. Në rast se madhësia e materialit tejkalon atë që mund të dërgohet me postë elektronike, pjesëmarrësit mund t'i ngarkojnë fotografitë me Wetransfer dhe të dërgojnë linkun nëpërmjet adresës së tyre të postës elektronike (jo drejtpërdrejtë nga Wetransfer), dhe të përfshijnë: emër, mbiemër, numrin e telefonit, datën e lindjes dhe titullin e fotografisë/fotografive.

Përzgjedhja dhe çmimet

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të caktojë një panel prej tre gjyqtarësh për të vlerësuar aplikimet dhe për të përzgjedhur tre fotografitë fituese. Secila nga fotografitë do të vlerësohet në bazë të këtyre shtyllave: krijimtaria, frymëzimi, origjinaliteti dhe lidhja me temën.

Pas konkursit, do të mbahet një ceremoni për dorëzimin e çmimeve dhe një ekspozitë e fotografive të përzgjedhura gjatë ‘Javës së Paqes’ organizuar nga UNAA (United Nations Association Albania) në datat 26-30 prill 2022. Datat e ekspozitës do të bëhen të ditura me mbylljen e konkursit. Te gjitha rezultatet do të botohen në faqen zyrtare të Prezencës së OSBE-së: www.osce.org/albania.

Çmimet do t'u vihen në dispozicion fituesve brenda dy muajve nga dita e ceremonisë së ndarjes së çmimeve, duke ndjekur rregullat dhe rregulloret e OSBE-së, dhe pas përfundimit me sukses të të gjitha procedurave të brendshme për dorëzimin e çmimeve.

Nëse punimi i një kandidati merr një çmim, mënyra dhe hollësitë e shpalljes të këtij nominimi dhe çmimi do të kryhen nën kujdesin dhe maturinë e plotë të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Kandidatët duhet të mirëkuptojnë që disa ose të gjitha çmimet nuk do të jepen apo publikohen në të njëjtën mënyrë apo formë.

Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përdorimit[5]

Duke marrë pjesë në konkurs, ju pranoni dhe kuptoni që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri lejohet të marrë dhe të përdorë informacionin personal të kërkuar dhe të dhënat e regjistrimit.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri pret që të gjitha punimet të jenë origjinale dhe që pjesëmarrësi ose të zotërojë punimin e paraqitur ose të ketë leje nga një klient apo palë tjetër e përshtatshme për të konkurruar me këtë punim, duke pasur kështu të gjitha të drejtat e dhëna. Rrjedhimisht, pas dorëzimit, pjesëmarrësi vërteton dhe garanton se fotografia/fotografitë e dorëzuara nuk cenojnë të drejtat e autorit ose të drejtat e palëve të treta. Në rast se një pjesëmarrës nuk i ka këto të drejta dhe paraqet një punim, atëherë pjesëmarrësi nuk do të kualifikohet për konkurs. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nuk mban përgjegjësi për asnjë shkelje të së drejtës së autorit nga ana e pjesëmarrësit. Fotografitë që përmbajnë imazhe të individëve nën moshën 18 vjeç duhet të marrin pëlqimin me shkrim të prindërve të tyre. Për fotografitë e bëra në hapësira dhe vende publike nuk kërkohet leje/pëlqim paraprak nga personat e shfaqur në foto, përveç rasteve kur fotot përdoren në mënyrë të tillë që cenon privatësinë e tyre.

[5] Dokumenti heqjes së përgjegjësisë për çmimet e fotografisë MUSE gjenden këtu:
<https://photocontestdeadlines.com/photo-contest-list/muse-photography-awards-2022/>